




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Direkcija za Poljoprivredu, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

Raporti i Punës (VITI 2024)

Misioni:

Misioni i Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) ka për objektivë udhëheqjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues, i fokusuar në trajnimin dhe mbështetjen e fermerëve në Komunën e Skenderajt.

Vizioni:

Vizioni ynë është puna e përgjegjshme duke përdorur aftësitë profesionale dhe shkencore në mënyrë që të zhvillojmë sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

MSC. Behxhet Maliqi

Drejtore për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural (Komuna Skenderaj)

Tel: +383 (0) 38/200-42-738

Mob: +383 (0) 48- 123-770

E-mail: behxhet.maliqi@rks-gov.net

Adresa: Rruga "28 Nëntori" Skenderaj.



Skenderaj, Janar 2025

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësi të saja në funksion të zbatimit të drejtpërdrejt të ligjeve:

- ✓ Ligjin për tokën bujqësore Nr.02/L-26;
- ✓ Ligjin për mbrojtjen e bimëve Nr.02/L-120;
- ✓ Ligjin për gjueti Nr.02/L-53;
- ✓ Ligjin për bletari Nr.02/L-111;

- ✓ Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, si dhe dispozitat e statutit të Komunës së Skenderajt (neni 11, paragrafi 2, pika 3) Nr.01-013/491 si dhe mbështetur në rregulloren Komunale për menaxhimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, mbrojtjen e bimëve, përkujdesjen ndaj kafshëve, mbrojtjen e faunës së egër dhe bletarin.

RAPORTI I PUNËS
DREJTORIA PËR BUIQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
VITI (2024)

Aktivitetet që janë realizuar gjatë vitit 2024:

1. Është realizuar monitorimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore.
2. Është realizuar ofrimi i informacioneve rreth granteve për mbështetjen e fermerëve nga MBPZHR.
3. Ndarja e granteve për fermerët e Skenderaj nga DBPZHR për vitin 2024 dhe bashkëpunimet me donatorët. Ku në kuadër të këtyre granteve janë shpërndarë këto pajisje bujqësore:
 - 35 copë mbjellëse misri.
 - 35 copë mbjellëse gruri.
 - 97 përfitues fidanë speci, tranguj dhe domate.
 - Serra për 74 familje përfituese.
 - Pula vojse për 100 familje përfituese (nga 40 pula).
 - Puse për ujë te pijshëm për 68 familje.
 - 8 copë laktofriza.
 - 3 copë motokultivator.
 - 9 përfitues me nga 8 koshere me blete dhe mjete te punës.
 - 4 përfitues me inkubator për zogj.
4. Ne kuadër të punëve të përditshme në drejtori janë realizuar edhe aplikimet për subvencione ku në këtë vit kanë aplikuar 1.762 fermer për sipërfaqet e mbjellë. 923 fermer për subvencionim të plehut artificial dhe sasisë se grurit te dorëzuar.
5. Aplikimet për subvencione për qumësht dhe majmëri dy herë gjate vitit 2024 ku kanë aplikuar mbi 123 fermer.
6. Ne kuadër të angazhimeve që ka drejtorja dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qentë endacak kemi arritur marrëveshje për trajtimin e qenve endacak me fondacionin zviceran "StrayCoCo" ku gjatë vitit 2024 janë trajtuar rreth 375 qenë endacak (kasttrim dhe sterilizim) ndërsa janë trajtuar me eutanazi 45 qenë.
7. Është përfunduar procesi i dhënies me qira te vendgjuetise "Drenica" dhe ka filluar menaxhimi i kësaj vendgjuetie sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.

8. Është realizuar monitorimi i procesit të korrje-shirjeve në të gjithë terrenin e komunës së Skenderaj nga ana e komisionit të formuar për këtë proces.

Janë organizuar trajnime në kuadër të projektit Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore në këto tema:

1. Kultivimi i pemëve frutore dhe mirëmbajtja e tyre.
2. Varietete, mbjellja dhe kultivimi i grurit.
3. Kultivimi i perimeve në serë dhe fushë të hapur.
4. Prodhimi higjienik i qumështit.
5. Kujdesi ndaj bletëve dhe kultivimi i tyre.
6. Të ushqyerit e lopëve qumështore gjatë fazës së laktacionit.

Falenderim të veçantë kemi ndaj donatorëve të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në mbështetje të fermerëve tanë. Në këtë vit kemi shtuar edhe numrin e donatorëve bashkëpunues këta janë donatorët kryesor:

1. Islamic Relief Kosova.
2. IADK (Iniciativa për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës)
3. Qatar Charity Kosova.